

AKT - THEMELIMI

(Kontrate)

I

SHOQERISE TREGETARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
E QUAJTUR "NDERMARE RE" ME KATER ORTAKE.

Ne mbeshtetie te nenit 2, & 1, shkronja "q", te Ligjit Nr.7512, date 10.8.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se li-re te veprimtarise private", si dhe te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 " Mbi shoqerite tregtare", ne, personat private Beqir Shehu, i biri i Shaqirit, lindur ne Peshkopi me 6.2.1949 dhe banues ne Elbasan, Lagjia "Sul Papi", P.131 shk.B, ap.12, - Hektor Bejko, i biri i Njaziut, lindur ne Gramsh te Shkraparit me 10.3.1950 dhe banues ne Elbasan ne Lagjen "5 Maj", P.700/3, shk.1, ap.9.- Amedan Halla, i biri i Xhevatit, lindur me 30.7.1952 ne Trebisht te Peshkopise dhe banues ne Elbasan, ne Lagjen "Dyl Haxhire", P.1/1, shk.1, ap.10.- Arbana Leka, e bija e Rexhepit, lindur ne Elbasan me 30.3.1964 dhe banuese ne Elbasan ne Lagjen "Brigada 17 Sulmuese", P.87, shk.C, ap.6, me vullnetin e tyre te shprehur ne kete Akt-Themelimi (kontrate) - T H E M E L O J N E - Shoqerine Tregtare Private te Ndertim-Montimit me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "NDERMARE RE" me kater ortake themelues, sot me daten 15.8.1994.

F O R M I M I

Neni 1

Formohet Shoqeria Private Ndertim - Montimit e quajtur "NDERMARE RE" me kater ortake themelues, zoterinjte: - Beqir Shehu, Hektor Bejko, Amedan Halla dhe Arbana Leka.

Shoqeria do te jete me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa degjet qe mund te krijohen do ti nenshtrohen edhe legjislacionit te vendit ku do te kete seline.

Shoqeria do te ushtroj veprimtarine e saj ne baze te ketij Akti-Themelimi dhe Statutit qe i bashkangjitet, te cilet jane miratuar nga te kate ortaket themelues.

VEND QENDRIMI I SHOQERISE.

Neni 2

Shoqeria do te kete vend qendrimin e saj ne Elbasan, ne Lagjen "Beqir Dardha", perball Shkolles Pedagogjike.

Aktiviteti i Shoqerise do te kryhet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ne menyre ambulatorie, me njesi apo mund te çeli edhe zyra perfaqesimi, axhensi apo filiale edhe ne rrethet e tjera te vendit, te organizuara me qender ne Elbasan. Si dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

Ndryshimi i Selise behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

Neni 3KOHE ZGJATIA E SHOQERISE.

Shoqeria do te kete nje kohe zgjatje me nje afat te pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne qdo kohe dhe per ç'fardo shkak me vendim te Asamblese se ortakeve.

OBJEKTI I VEPRINTARISENeni 4

Objekti i veprintarise se Shoqerise do te jete:

Ndertimeve industriale, turistikë, civile, bujqesore dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime restaurimi, vepra beton/arme te vecanta Punime dheu, murature, betoni, beton arme te zakonshme, punime shembiesh, ndertimi m autostradash e rruges, Prodhim e tregetim materiale ndertimi, inerte, e tje Shitblerise me shumice dhe pakice, eksport import te mallrave te ndryshme industriale, konfeksione, tekstile, paisjeve elektroshtepijake, hidrosanitare, ushqimore, ushqim social, produkteve bujqesore e blektorale, artikujve kimike, kozmetike, fruta perime, pijsjeve alkalike e freskuese, lende drusore, lende te para, gjysem fabrikate, makineri e paisje e pjes nderimi, karburante e vajra lubrifikante, nenprodukteve te naftes, bar-bufe, restorant, restiçeri, hoteleri, turizem, prodhime sheqeri, prodhime brumrash e mishi, e tje.

Transport mallrash te te gjitha llojeve dhe udhetareve brenda e jashte vendit, si dhe tregetim automjetesh e pjes kembimi per to te ndryshme, sherbime te ndryshme servisi, parking, spedicione, e tje. Operacione tregetare komisionarie, marketingu, Kreditime legale, kambizem dhe qdo lloj veprintarie financiare, Investime te ndryshme ose kapitale ne fusha te ndryshme. -Si dhe qdo veprintari tjeter qe do te shikohet me interes nga Shoqeria.

KAPITALI I SHOQERISENeni 5

Kapitali fillestar i Shoqerise themelor do te jete 100.000 leke, i perbere nga kuota e derdhur nga te kater ortaket themelues te Shoqerise ne menyre te barabarte, nga 25% sejcili, pra nga 25.000 leke sejcili.

Neni 6

Kapitali eshte ndare nga 100 pjese te barabarta, nga 1000 leke sejcila pjese dhe qe te gjitha pjeset jane te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortaket themelues te Shoqerise.

Neni 7

Ortaket themelues duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te Shoqerise, te ruajne sekretin e saj, te mos demtojne interesat e Shoqerise dhe te personave te tjere.

Neni 8

Pitimi i Shoqerise do te ndahet midis paleve (pronareve) ne raport

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

3.
me perqindjen e pjesmarrjes ne kapitalin themelor te derdhur nga ortakët.

Neni 9

Shoqeria merr persiper te shlyej te gjitha detyrimet qe i linden gja te veprimtarise se saj dhe pergjigjet me kapitalin e saj.

Neni 10

Shoqeria pergjigjet per veprimet e veta me pasurin e saj. Ajo nuk pergjigjet per detyrimet qe kan punonjesit e tjere nga aktiviteti i tyre jashte kesaj Shoqerie.

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 11

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asambleja e ortakeve

Drejtori Administrativ

Keshilli Administrativ

Fusha e veprimit, perberia dhe menyra e punes ne organet drejtuese emrimi dhe shkarkimi i anetareve dhe qeshtie te tjera te rendesishme per funksionimin e tyre rregullohen sipas ketij Akti-Themelimi e Statutit qe i bashkangjitet. Asambleja e ortakeve te Shoqerise drejtohet nga Drejtori Administrativ dhe ne munges te tij nga personi i autorizuar prej tij me prokure.

Shoqeria Private "Shehu" SHPK drejtohet nga Drejtori Administrativ i saj zoti, Beqir Shehu dhe administratori ekzekutiv zoti, Hektor Bejko.

Neni 12

Organi vendimor i Shoqerise eshte Asambleja e ortakeve. Vendimet e saj ciles jane te detyrueshme per te gjithë punonjesit e Shoqerise, kur ato jane marre nga te kater ortakët themelues te Shoqerise, ose me 3/4 e votes.

Neni 13

Shoqeria administrohet nga Keshilli Administrativ, qe perbehet nga administratorët e emruar nga Asambleja, dhe eshte organ konsultativ i Shoqerise.

BILANCI DHE TE ARDHURAT.

Neni 14

Veprimet ekonomiko financiare te Shoqerise mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti. Ne fund te çdo periudhe ushtrimore administrata nxjerr bilancin kontabel te Shoqerise me rezultatin Fitim - Humbje.

Bilanci kontabel vjetor miratohet nga Asambleja e ortakeve. Me miratimin e bilancit kontabel vjetor Shoqeria vendos per krijimin e fondeve rezervave, fondin e akumulimit, e tje.

SHPERBERIA E SHOQERISE

Neni 15

Shperberia e Shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çfarëdo shkak, duke vepruar sipas kriterëve qe parashikohen ne Statut.

MARDHENIET E PUNES.

(Handwritten signatures and initials)

Neni 16

Mardheniet e punes ne Shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes qe lidhet midis paleve ne baze te Ligjes Nr.7526, date 3,12.1991 " Per mardheniet e punes".

Neni 17

Mosmarveshiet qe mund te lindin gjate zhvillimit te aktivitetit te Shoqerise me te punesuarit apo te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirkuptim ndermjet paleve, qeshtia mbetet ne kopetence te gjykates qe e shqyrton ate.

DISPOZITA TE PERGJITHESHMENeni 18

Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe do te zhvilloj aktivitetin e saj ne baze te Ligjit Nr.7512, date 10.8.1991, te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, te kodit civil e te akteve te tjera ligjore e nen ligjore te dala ne zbatim te tyre. Ajo deklarohet e krijuar ne zbatim te normave te plota e Statutit.

Neni 19

Shoqeria ka valen e saj te rrumbullaket, me madhesi te zakonshme, me tekst per rreth saj.

Neni 20

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet pran Institutit te Sigurimeve te Shqiperise.

Neni 21

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organi kopetent nga Zyra e Tatimeve. Akti i Themelimit u perpilua ne disa kopie per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopie mbetet me dokumentacionin ne baze te Shoqerise.

Akti i Themelimit nenshkruhet rregullisht nga te kater ortaket themelues te Shoqerise para noterit.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE.

1.- Beqir Shehu, 2.- Hektor Bejko 3.- Amedan Halla, 4.- Arbana Leka.

REPUBLICA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr. 443 Rep; 445 Kol.

Tirane me _____ 1994

VERTETIM

Vertetohet se sot me daten 22.8 1994, ne Zyren e Noterise se Tiranes u paraqiten ortaket themelues te Shoqerise Private "SHEHU" SHPK zoterinjte, Beqir Shaqir Shehu, Hektor Njazi Bejko, Amedan Xhevat Halla dhe Arbana Rexhep Leka, te cilet nenshkruan para meje noteres kete kontrate te kesaj Shoqerie dhe une noteria e vertetove



NOTERIE

STATUT

I

SHOQERISE TREGETARE PRIVATE NDERTIM MONTIM, ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR, E QUAJTUR "NDERMAREJA, E RE" SHPK.

FORMIMI

Neni 1

Formohet Shoqeria Tregetare Private Ndertim Montim me pergjegjesi te kufizuar "NDERMARE RE" ortakeve te saj themelues:

- 1.- Beqir Shaqir Shehu, banues ne Elbasan.
- 2.- Hektor Njazi Bejko, " "
- 3.- Amedan Xhevat Halla, " "
- 4.- Arbana Rexhep Leka, " "

Shoqeria fiton personalitetin juridik qe nga data e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane. Ajo eshte per on juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, te akteve te saj themeluese, e sidomos te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992; " Mbi shoqerite tregetare".

Neni 2

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget agjensite, filialet apo perfaqesite qe mund te krijohen do ti nenshtrohen edhe legjislacionit te vendit ku do te kene seline.

Shoqeria Private "NDERMARE RE" eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbiet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre te derdhur ne kapitalin themelor.

VEND QENDRIMI I SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria e ka vend qendrimin e saj me qender ne Elbasan, ne Lagjen "Beqir Dardha", perball Shkolles Pedagogjike.

Shoqeria mund te hapi dhe vend qendrim te tjera te dyta, pra aktiviteti i saj do te kryhet ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise ne menyre ambulatorie, me njesi apo mund te çeli edhe zyra perfaqesimi, agjensi apo filiale edhe ne rrethet e tjera te vendit, te organizuara me qender ne Elbasan, si dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

Çdo ndryshim i selise behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

Neni 4


KOHE ZGJATIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete nje kohe zgjatje me nje afat te pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per ç'fardo shkak nga Asambleja e ortakeve themelues.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete ne fushen e :



Ndertimeve e montimeve te veprave industriale, turistike, civile, bujqesore, si dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime restaurimi, vepra beton/arme te veqanta, punime dheu, murature, betoni, beton arme te zakonshme, punime shembiesh, ndertim autostradash e rruges, Prodhim e tregetim materiale ndertimi, inerte, e tje.

Shitbleries me shumice dhe pakice, eksport import te mallrave te ndryshme industriale, konfeksione, tekstile, paisje elektroshtepijake, hidrosanitare, ushqimore, ushqim social, produkte bujqesore e blektorale, artikuj kimike, kozmetike, fruta perime, pijeve alkolike e freskuese, lende drusore, lende te para gjysem fabrikate, makineri e paisje e pjes kembimi, karburante e vajra lubrifikante, e nenprodukte te naftes, bar-bufe, restorant, restoranti, hoteleri, turizem, prodhime sheqeri, prodhime brumrash e mihi , e tje.

Transport mallrash te te gjitha llojeve e udhetarsh, brenda e jasht vendit, si dhe tregetim automjeteve e pjes kembimi per to te te gjitha llojeve sherbime te ndryshme servisi, parking, spedicion, e tje. Operacione tregetare komisionarie, marketingu, kambizem. Kreditime legale dhe çdo lloj veprimtarie financiare. Investime te ndryshme ose kapitale ne fusha te ndryshme.-- Si dhe çdo veprimtari tjetër që do të shihet me interes nga Shoqëria.

Neni 6

Per kryerjen e veprimtarise se saj Shoqëria do te hape njesi grup-bulluese, perpunuese, sherbimi e tregetimi, si dhe do te bashkpunoje me persona fizike e juridike, vendas dhe te huaj.

KAPITALI I SHOQËRISE

Neni 7

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë Private "SHEHU" SHPK do te jete 100.000 leke, i perbere nga kuota e derdhur nga te kater ortakët themelues te saj ne menyre te barabarte, nga 25% sejcili, pra nga 25.000 leke sejcili.

Neni 8

Kapitali eshte vene nga te kater ortakët themelues te Shoqërisë, nga zoterinjte, Beqir Shehu, Hektor Bejko, Amedan Halla dhe Arbana leka dhe eshte ndare ne 100 pjese te barabarta, nga 1000 leke sejcila pjese. Te gjitha pjeset e kapitalit nenshkruhen dhe shlyhen plotesisht nga ortakët themelues te Shoqërisë.

Neni 9

Shoqëria mund te rriti pjeset e kapitalit te saj themeltar gjate aktivitetit te saj, por nuk mund ta pakesoj ate non kufirin e 100.000 lekshit, qe eshte percaktuar ne Ligjin Nr.7638, date 19.11.1992" Mbi shoqëritë tregëtare" me pergjegjesi te kufizuar. Ky ehtim ose pakesim behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

Neni 10

Pjeset e kapitalit themelor jane lirisht te transferueshme ne rruge

W

Beqir

Hektor

Amedan

trashëgimie, ne rast vdekje te ortakut, pjesa e tij e kapitalit kalon te trashëgimtari, dhe kur asnjëri nga prëstaret e familjes nuk pranon te punoje ne ortakëri, atehere u jepen te gjitha fitimet qe i takojne sipas shumes se derdhur ne kapital. Trashëgimtari hyn ne Shoqëri te ortakëve me te gjitha te drejtat e ortakut dhe me te gjitha efektet. Ne qofte se trashëgimtari eshte i vogël bashkeshorti i tij, per aq kohe sa trashëgimtari te jete i afte per pune.

Neni 11

Me pelqimin e ortakëve themelues pjeset e kapitalit jane te transferueshme te persona te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqëri. Ne rastin e shtimit te ortakëve pjeset e kapitalit mund te transferohen me pelqimin e tyre (te shumices) ne rast se ata perfaqesojne 3/4 e kapitalit themeltar. Transferimi i kapitalit do te vertetohen me akt noterial.

Neni 12

Kapitali i Shoqërise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiroros dhe te tjera te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te Shoqërise.

Neni 13

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik te Shoqërise do te administrohet nga te kater ortakët. Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregëtar. Shoqëria eshte e detyruar te shlyej te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.

Neni 14

Shoqëria Private "SHEHU" SHPK eshte disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje e te shfrytëzoje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejta per shitjen e pasurise se vet tek te tretet.

Ne Republikën e Shqipërise Shoqëria gëson te drejta sikander çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 15

Shoqëria vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarise se Shoqërise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

Neni 16

Çdo ortak ka te drejte te largohet nga Shoqëria, duke njoftuar dhe duke dhene shpjegimet perkatese per largimin e tij. Kuotat e kapitalit mund te shiten vetem midis ortakëve, sipas vleres se pergjitheshme te realizuar deri ne ate moment nga Shoqëria. Oferta behet ne ate menyre, ne perputhje me kuotat e poseduara nga çdo ortak dhe i u behet e njohur me shkrim atyre ortakëve qe jane te rregjistruar ne librin e ortakëve, duke i u lene nje kohe maksimum prej 30 ditesh per te vendosur per te drejten e tyre te parazgjedhies. Me te

re *Shelley* *PHG* *Shelley*

skaduar ky afat, ortaku shites, me aprovim paraprak te Asamblese se ortakeve ka te drejte te shese kuoten te treteve, por jo me qmim me te ulet se ajo e ofruar ortakeve te tjere. Asambleja e ortakeve ka nje kohe ne dispozicion pre 30 diteah per tu shprehur, per te dhene miratimin e saj dhe ne rast mos pergj gje brenda ketij afati miratimi quhet i dhene.

Neni 17

Shoqeria eshte pronare e mjeteve te saj. Ajo ka te drejte te perdo-re dhe te disponoje mjetet e saj ne perputhje me objektin e veprimtarise qe kryen, dhe ti mbroj ato sipas dispozitave ligjore.

Neni 18

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket kane natur para se te krijohej Shoqeria, ose per detyrimet qe mund tu lindin jashte veprimtarise se Shoqerise. Shoqeria ka te hapur llogarine e saj rjedhese ne Banke, neparamjet te ciles kryen veprime ekonomike, financiare me partnere te trete, vendas ose te huaj, duke likuiduar ne monedhe shqiptare apo te huaj, sipas marveshieve te perfunduara.

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 19

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

Asambleja e ortakeve

Drejtori Administrativ

Keshilli administrativ

Organi vendimor i Shoqerise eshte Asambleja e ortakeve te Shoqerise e cila perbehet nga ortaket themelues te saj, zoterinjte: Beqir Shehu, Hektor Bejko, Amedan Halla dhe Arbana Lekca.

Themeluesit e Shoqerise e qeverisin ate duke u mbeshtetur ne te drejtesajten e tyre te prones private me mjete te investuara ne kete Shoqeri.

Vendimet qe merr Asambleja sipas ligjeve ne fuqi dhe ketij Statuti jane te detyrueshme per te kater ortaket e Shoqerise. Vendimet e Asamblese formulohen dhe firmosen nga Drejtori Administrativ i saj. Asambleja thirret sa here ta shohin te arsyeshme ortaket themelues, por detyrimisht ne muajin Dhjetor per te miratuar programin e veprimtarise se Shoqerise per vitin e ardhshem dhe ne muajin Mars per te miratuar bilancin kontabël per vitin e meparshem.

Neni 20

Themeluesit e Shoqerise me vendim te posaqem te Asamblese zgjedhen Drejtorin Administrativ te saj, zotin Beqir Shehu dhe si administrator ekzekutiv zgjedhen zotin Hektor Bejko.

Asambleja e Shoqerise percakton dhe miraton te drejtat dhe detyrat e organeve te saj, duke filluar nga ato te vet Drejtorit Administrativ, Asamblese, si dhe te administratoreve.

ms

Bejko

%

AAleg

Alba

Asambleja e ortakeve ka te drejte te vendose:

Ndryshimin e Statutit te Shoqerise, shperndarjen e parakohshme te Shoqerise, mitatimin e krijimit te degëve te reja, pranimin e ortakeve te rinj ose perjashtimin e ortakeve te Shoqerise ose te punonjesve te tjere eksistues miraton raportet e administrimit, zvogelon ose rrit kapitalin themelor, inventaretin bilancin, llogarive periodike dhe vjetore te hartuara nga administratorë transferon fitimet ne banka te ndryshme edhe jashte shtetit, emron e shkarkon administratorët.

Vendimet e Asamblese merren ose kane fuqi kur ortaket jane te nje mendimi, ne rast te kundert vendimet merren me ane te votes.

Neni 21

Asambleja drejtohet nga Drejtori Administrativ, nga zoti Beqir Shehu. Ai ka te drejte te jape urdhra e udhezime, si dhe porosi administratorëve e punonjesve te tjere te Shoqerise per menyren e veprimit dhe te realizimit te veprimtarise se tyre. Ne munges te Drejtorit Administrativ keto detyra i realizon personi i ngarkuar prej tij me prokure, prokura keto te revokueshme ne çdo kohe nga ai. Urdhrat e dësponimet e tjera te Drejtorit Administrativ jane te detyrueshme per te gjithë pjestaret e Shoqerise.

Neni 22

Sejcili ortak qe ka te drejten e pjesmarrjes ne Asamble mund te perfagesohet ne te edhe nga nje ortak tjetër i Shoqerise, ose punonjes ne Shoqeri, duke i dhene perfagesim me shkrim. I takon Drejtorit Administrativ te Shoqerise te njoh te drejten e pjesmarrjes ne Asamble, qofte edhe per te deleguarit ne Shoqeri.

Per çdo vendim qe merret ne Asamble mbahet procesverbali i veçante qe firmoset nga Drejtori Administrativ.

Neni 23

Shoqeria ~~administrtohet~~ nga nje Keshill Administrativ, qe perbehet nga administratorët e emruar nga Asambleja e ortakeve. Keshillin e drejton Kryetari i tij, qe eshte Drejtori Administrativ i Shoqerise.

Neni 24

Keshilli administrativ duke marre vendime cakton çmimet e shitbleries, organizon kontrollin periodik te veprimtarise, siguron administrimin e mire te veprimtarise, cakton pagat e punonjesve, demshperblimet, shperblimet, propozon per rritjen e pagave te punonjesve ne mbledhjen e Asamblese.

Neni 25

Drejtori Administrativ eshte i veshur me te gjithë fuqin per drejtimin e zakonshem dhe te jashtzakonshem te Shoqerise, pa asnjë kufizim. Ai kryen te gjitha ~~aktet~~ qe konsiderohen te pershtateshme per arritjen e qelimit te Shoqerise. Ai ka te drejte te bleje dhe te kembeje pasuri, te lidhen me Shoqeri te tjera te ngritura ose qe do te ngrihen brenda dhe jashte ven-

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

duke siguruar pjesmarrje per qellimet e veprimtarise te parashikuara nga neni 5 i Statutit. Ai kryen qdo lloj veprimtarie prane te gjitha zyrave shteterore dhe private, qe kane te bejne me garancite e veprime ipotekare. Te kryej prane institucioneve bankare dhe financiare veprime deponitimi, kreditimi, pagesa dhe arketime, si dhe veprime te tjera.

Neni 26

Drejtori Administrativ e humbet detyren e tij ne rastin e prishies se Shoqerise dhe kur eshte i zgjedhur shkarkohet nga ortaket themelues, Asambleja e ortakeve.

Neni 27

Ortaku themelues e humbet te drejten e ortakerise kur:

Kerkon vet largimin e tij nga Shoqeria. Kur perjashtohet me vendim te Asamblese se ortakeve (ortakeve themelues) ose me shumice 2/3 te ortakeve te Shoqerise.

Neni 28

Ortaket e shoqerise jane pergjegjes individualisht ose solidarisht e sipas rastit ndaj Shoqerise ose te treteve, per shkelie te ligjeve, per shkelie te Statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

MARDHENIET FINANCIARE DHE BILANCI

Neni 29

Shoqeria mund te lidhi kontrata me sektore shteterore, drejtperdrejt ne tregun e lire, si dhe me persona juridike e fizike vendas dhe te huaj.

Neni 30

Ne veprimet kontraktuale Shoqeria perfaqesohet nga Drejtori Administrativ, ose persona te tjere te caktuar prej tij. Te drejtat e detyrimet qe rjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per Shoqerine.

Neni 31

Shoqeria pergjigjet per detyrimin fiskal, afatet e derdhies se tij, sigurimet shoqerore e tje. Per pasqyrimin e aktivitetit privat Drejtori Administrativ ose persona te tjere te caktuar prej tij, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrat perkates sipas ligjit te vesante.

Neni 32

Veprimtaria e Shoqerise mbaron me 31 Dhjetor te qdo viti. Drejtori Administrativ ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklaraten e te ardhurave dhe te deponitohen ne organin financiar te juridiksionit perkates (Zyres se tatimeve).

MARDHENIET E PUNES

Neni 33

Mardheniet e punes ne Shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes qe lidhet midis paleve, ne mbeshtetie te Ligjit Nr. 7526, date 3.12.1991

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

" Per mardheniet e punes".

Neni 34

Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne librin e punes se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet perkatese, te punes ku ushtron aktivitetin Shoqeria.

Neni 35

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortakut themelues .Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkelieve disiplinore, ose me vet ketkesen e te interesuarit.

Neni 36

Largimi nga Shoqeria behet pasi jane shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

DISPOZITA TE TJERA TE PERGJITHESIME

Neni 37

Mosmarrveshiet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise do te zgjidhen me mirkuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirkuptimi nuk eshte i mundur, pale i drejtohen gjykates.

Neni 38

Te ardhurat neto, pas veqimit te fondeve ligjore te nevojshme, te akumulimit, te reserves, dhe te pagimit te detyrimeve fiskale i mbesin per perdorim ortakeve themelues te Shoqerise. Fitimi i realizuar nga Shoqeria ndahet ne menyre te barabarte, ne pjes te barabarta nga ortaket, pra nga 25% sejeili ortak.

Neni 39

Shoqeria mund te shperbehet ne qdo kohe dhe per q'fardo shkak, si humbie e kapitalit, pamundesi veprimtarie, nuk figuron fitimprurese, per shkak te forces madhore, e tja.

Pronaret e Shoqerise vendosin per menyren e likujdimit dhe caktojn nje ose me shume likujdatore, duke ju percaktuar detyrat. Likujdatorët dhe administratorët jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se Shoqerise per deri sa t'iu dorzohet personave fizike dhe juridike, duke likujduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete.

Ne se fondet nuk mjaftojne per shlyerjen e detyrimeve te Shoqerise likujdatorët mund tu kerkojne ortakeve te Shoqerise te derdhin pjeserisht kuota te nevojshme qe ju takojne respektivisht.

Pasi shlyen te gjitha detyrimet qe Shoqeria i u ka personave te trete fizike e juridike behet njoftimi i mbylljes ose i likujdimit duke kryer formalitetet perkatese, duke q' rregjistruar Shoqerine nga Bregjistri Treg getar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

Themeluesit e Shoqerise ne qdo kohe mund te bejne ndryshime e plot
tesime ne Statut pa rrene ndesh ne menyre thelbesore me nenet qe jane parashk-
ruar ne Statut.

Ndryshimet e plotesimet e ketij Statuti behen ne te njejten menyre
e procedure me te cilen nxirret vet Statuti.

Neni 41

Persa nuk eshte shprehur ne Statut, gjitheshka i referohet Ligjit
Nr.7638, date 19.11.1992 " Mbi shoqerite tregtare, ne veganti dhe legisla-
cionit shqiptar ne pergjithesi.

Neni 42

Shoqeria ka vulen e saj te rrumbullaket, me madhesi te zakonshme ,
me tekst per rreth saj.

Neni 43

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet prane Institutit te Siguri-
meve te Shqiperise.

Neni 44

Ky Statut perpilohet ne disa kopie per t'iu shperndare organeve
kopesente dhe nje kopie mbetet me dokumentacionin baze te Shoqerise.

Statuti i perpiluar nenshkruhet rregullisht nga te kater ortaket t
themelues te Shoqerise tregtare Private Ndermarrjes Ndertim Montimit "E RE"
SHPK me zoterinjte Beqir Shehu, Hektor Bejko, Amedan Alla dhe Arbana Leka.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE (NDERMARRJES) PRIVATE NDERTIM
MONTIMIT " E RE " SHPK

- 1.- Beqir Shehu 2.- Hektor Bejko 3.- Amedan Alla 4.- Arbana Leka.

Beqir Shehu *Hektor Bejko* *Amedan Alla* *Arbana Leka*